



Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale
Sektori i Kualifikimeve Profesionale

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“FRUTIKULTURË”

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²
K-H1-III-24

Tiranë, 2024

¹Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbatja

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja	4
Niveli.....	4
Qëllimi:	4
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	4
Ofruesit	4
Data e validimit.....	4
Data e miratimit	4
Variantet e mëparshme	5
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT	5
Kompetenca të përgjithshme (qëndrimet).....	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	5
H1-08-III-0152-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në frutikulturë	5
Rezultatet e të nxënit në njohuri	5
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	6
Kriteret e vlerësimit	6
H1-08-III-0153-24 Kushtet mjedisore të fermës për prodhimin në frutikulturë	7
Rezultatet e të nxënit në njohuri	7
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	7
Kriteret e vlerësimit	7
H1-08-III-0154-24 Teknologjia e prodhimit të fidanëve të pemëve frutore dhe hardhive	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri	8
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	8
Kriteret e vlerësimit	8
H1-08-III-0155-24 Teknologjitë e kultivimit në pemëtore dhe vreshta	9
Rezultatet e të nxënit në njohuri	9
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	10
Kriteret e vlerësimit	10
H1-08-III-0156-24 Shërbimet agroteknike dhe vjelja në pemëtore e vreshta	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri	11

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	11
Kriteret e vlerësimit	11
H1-08-III-0157-24 Përpunime të thjeshta të prodhimeve të pemëve frutore	12
Rezultatet e të nxënit në njohuri	12
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	13
Kritere vlerësimi	13
H1-08-III-0158-24 Teknologjitë e prodhimit biologjik në frutikulturë	13
Rezultatet e të nxënit në njohuri	13
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	14
Kritere vlerësimi	14
H1-32-III-0013-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere.....	15
Rezultatet e të nxënit në njohuri	15
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	15
Kritere vlerësimi	15
H1-31-III-0014-24 Komunikimi dhe etika profesionale.....	16
Rezultatet e të nxënit në njohuri	16
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	16
Kritere vlerësimi	16
H1-08-III-0047-24 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit	16
Rezultatet e të nxënit në njohuri	16
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	17
Kriteret e vlerësimit	17
Njësitë e të nxënit dhe peshat përkatëse:	18
Modalitetet e vlerësimit	18
Informacion shtesë	19
SHËNIM	19

Emërtimi i kualifikimit	Frutikulturë			Kodi
Kohëzgjatja	1500 orë nacionale	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	K- H1-III-24
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional “Frutikulturë” niveli III në KSHK , referuar nivelit III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar për në sektorin e frutikulturës për kultivimin dhe prodhimin e pemëve frutore, ullirit, agrumeve dhe hardhisë, duke zbatuar hallkat agroteknologjike. Ky kualifikim profesional mundëson rritjen e alternativave për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejtë me frutikulturën, si dhe zhvillimi i personalitetit të individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në profilin “Frutikulturë” të nivelit III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: – kanë përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, nivelin II në KSHK, referuar nivelit II të KEK; – janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Frutikulturë”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës, që përkon me nivelin e punonjësit të kualifikuar në fushën profesionale në tregun e punës, Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës, brenda dhe jashtë vendit, me drejtim frutikulturë: për prodhim fidanësh të pemëve frutore, ullinjve, agrumeve dhe hardhisë; për të shërbyer në pemëtoret e prodhimit; për të shërbyer në sektorin privat shtëpiak në zonat urbane dhe rurale; për vetëpunësim në fermën e tij vetjake. Në përfundim të këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, (teknik/menaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit	Korrik 2024			
Data e miratimit				

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional në profilin “Frutikulturë” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas njësive të të nxënës të mëposhtme:

Kompetenca të përgjithshme (qëndrimet)

Rezultatet e të nxënës të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënës.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
3. Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
6. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
7. Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
8. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
9. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
10. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
11. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
12. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
13. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
14. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet.
15. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij, për t'u përshtatur me evolucionin teknologjik.

NJËSITË E TË NXËNËS TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënës (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

H1-08-III-0152-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në frutikulturë

Rezultatet e të nxënës në njohuri

1. Të përshkruajë zhvillimet e fundit në fushën e kultivimit të pemëve frutore, vreshtave ullishtave dhe agrumeve;

2. Të listojë aktet ligjore e normative, që rregullojnë veprimtarinë e frutikulturës;
3. Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrat e planifikimit të punës me bazë ditore, javore dhe mujore;
4. Të shpjegojë organizimin e punës në një fermë me drejtim frutikulturë;
5. Të shpjegojë metodat e përzgjedhjes dhe ndarjes së detyrave sipas kualifikimeve përkatëse;
6. Të përshkruajë llojin e veprimtarive për kultivimin e pemëve frutore dhe vreshtave;
7. Të përshkruajë mënyrat dhe rëndësinë e planifikimit të kohës sipas kalendarit dhe radhës së punës;
8. Të shpjegojë llojin e materialeve, mjeteve dhe pajisjeve si dhe përdorimi dhe funksioni i tyre;
9. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të gatishmërisë për punë të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
10. Të përshkruajë mënyrat e pastrimit dhe mirëmbajtjeve të thjeshta të mjeteve, pajisjeve dhe vendit të punës,
11. Të përshkruajë materialet, mjetet e pastrimit dhe mirëmbajtjet e thjeshta;
12. Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrat e bashkëpunimit me eprorin dhe specialistë të tjerë;
13. Të përshkruajë format e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
14. Të përshkruajë formatet e dokumentimit të punës;
15. Të përshkruajë mënyrat dhe rëndësinë e raportimit tek eprori;
16. Të shpjegojë procedurat për hapjen e një ferme bujqësore me drejtim frutikulturë;
17. Të përshkruajë procedurat për ngritjen e plantacioneve në përputhje me standardet dhe teknologjinë e prodhimit;
18. Të shpjegojë elementët e projektit teknik (masat organizative, teknike dhe ekonomike) që zbatohen, për ngritjen e blloqeve të reja me pemëtore, vreshta, ullishte dhe agrume;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të planifikojë veprimtarinë në frutikulturë;
2. Të organizojë punën për realizimin e veprimtarive në frutikulturë;
3. Të menaxhojë burimet e nevojshme për realizimin e punës në frutikulturë;
4. Të zbatojë procedurat për ngritjen e plantacioneve sipas projektit teknik dhe në përputhje me standardet dhe teknologjinë e prodhimit;
5. Të dokumentojë dhe raportojë realizimin e detyrave sipas procedurave;

Kriteret e vlerësimit

- Planifikon veprimtaritë ditore, javore dhe mujore sipas objektivave të prodhimit;
- Planifikon proceset e punës në frutikulturë sipas llojit të kalendarit të punimeve;
- Planifikon kohën dhe radhën e punës sipas llojit të kulturave drufrutore;
- Planifikon materialet, mjetet dhe pajisjet e punës sipas proceseve të punës në frutikulturë
- Organizon punën në frutikulturë sipas aktivitetit të planifikuar;
- Përcakton detyrat dhe prioritetet e një plani prodhimi ditor, javor dhe mujor sipas objektivave;
- Organizon vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- Përzgjedh dhe përdor mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, sipas funksionit;

- Kontrollon gatishmërinë për punë të mjeteve dhe pajisjeve, sipas manualeve;
- Pastron dhe mirëmban mjetet, pajisjet dhe vendin e punës sipas instruksioneve përkatëse;
- Zbaton rregullat e higjienës së vendit të punës, sipas standardeve;
- Planifikon burimet e nevojshme njerëzore sipas proceseve të punës dhe kualifikimit përkatës të tyre;
- Përzgjedh burimet e nevojshme njerëzore sipas proceseve të punës dhe kualifikimit përkatës të tyre;
- Koordinon bashkëpunimin me eprorët dhe specialistë të tjerë në frutikulturë, sipas rregullores së brendshme;
- Zbaton procedurat për ngritjen e plantacioneve sipas projektit teknik dhe në përputhje me standardet dhe teknologjinë e prodhimit;
- Dokumenton në mënyrë periodike punën e kryer, sipas formateve përkatëse;
- Raporton në mënyrë periodike për realizimin e detyrave, sipas formateve përkatëse;

H1-08-III-0153-24 Kushtet mjedisore të fermës për prodhimin në frutikulturë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë ndikimin e faktorëve klimatikë dhe tokësorë në ngritjen dhe kultivimin e pemëtoreve dhe vreshtave të rinj;
2. Të përshkruajë rajonizimin e pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve sipas zonave klimatiko – tokësore;
3. Të shpjegojë përdorimet e mjeteve dhe pajisjeve digjitale për matjen dhe regjistrimin e parametrave klimatiko-tokësorë dhe sensorëve digjitalë për monitorimin e tyre;
4. Të përshkruajë mënyrat për grumbullimin dhe përpunimin digjital të informacionit agroklimatik;
5. Të shpjegojë llojet e tokave, cilësitë fiziko – kimike dhe karakteristikat e tyre;
6. Të shpjegojë rëndësinë e krahasimit të rezultateve të parametrave fiziko-kimikë të tokës me kërkesat e kultivarëve;
7. Të listojë metodat dhe teknikat e vlerësimit të kushteve klimatiko- tokësore;

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të vlerësojë kushtet mjedisore për kultivimin e pemëve frutore dhe vreshtave;
2. Të përzgjedhë pemët frutore, hardhitë, ullirin dhe agrumet në vendin tonë sipas zonave klimatiko – tokësore;
3. Të përdorë mjetet dhe pajisjet digjitale për matjen dhe regjistrimin e parametrave klimatiko-tokësorë dhe sensorëve digjitalë për monitorimin e tyre;

Kriteret e vlerësimit

- Dallon kushtet mjedisore për kultivimin sipas kulturave drufrutore dhe hardhive;
- Identifikon kushtet klimatike për kultivimin e kulturave drufrutore dhe hardhive, sipas kërkesave të tyre;
- Përzgjedh kulturat drufrutore dhe hardhitë sipas kushteve klimatiko-tokësore;
- Kryen matjen dhe regjistrimin e parametrave agrometeorologjikë me anë të teknologjisë digjitale sipas manualeve të përdorimit;
- Krahason të dhënat e parametrave agrometeorologjikë të përfituar me kërkesat e

kulturave drufrutore dhe hardhive;

- Zbaton masat mbrojtëse ndaj dukurive ekstreme klimatike (thatësi, përmytje, ngrica, breshër, zjarre etj.) në kultivimin e kulturave drufrutore dhe hardhive, sipas rastit;
- Dallon tokën, si mjedis natyror i rritjes së kulturave drufrutore dhe hardhive, sipas kërkesave të tyre;
- Identifikon cilësitë fiziko - kimike të tokës sipas kërkesave të kulturave drufrutore dhe hardhive;
- Krahason të dhënat e cilësive fiziko-kimike të tokës me standardet dhe sipas kërkesave të kulturave drufrutore dhe hardhive;
- Përdor mjetet dhe pajisjet digjitale për matjen dhe regjistrimin e parametrave klimatiko-tokësorë dhe sensorët digjitalë për monitorimin e tyre sipas manualeve përkatëse.

H1-08-III-0154-24 Teknologjia e prodhimit të fidanëve të pemëve frutore dhe hardhive

Rezultatet e të nxënësve në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e përzgjedhjes së farave dhe copave për fidanët;
2. Të shpjegojë mënyrat, teknikat dhe mjetet e përgatitjes së farishtës për mbjelljen e farës dhe copave;
3. Të shpjegojë mënyrat, teknikat dhe mjetet e përgatitjes së shtratit të nxehtë për mbjelljen e farës;
4. Të argumentojë rëndësinë e ruajtjes së raporteve për përgatitjen e dherishtës;
5. Të shpjegojë mënyrat e përdorimit dhe përpunimit të mbetjeve organike në përgatitjen e dherishtës;
6. Të shpjegojë mënyrat, afatet, distancat dhe thellësinë e mbjelljes së farave në farishte dhe/ose në shtratin e nxehtë;
7. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e shartimit të filizave dhe copave në shartesore;
8. Të listojë llojet e shërbimeve agroteknike në farishte/fidanishte dhe/ose në shtratin e nxehtë;
9. Të shpjegojë teknikat dhe mënyrat e shkëlqesës dhe pastrimit të fidanëve;
10. Të shpjegojë mënyrat e standardizimit të fidanëve pas shkëlqesës;
11. Të shpjegojë teknikat e shtratifikimit të fidanëve frutorë;
12. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e etiketimit dhe ambalazhimit të fidanëve sipas llojit të tyre;
13. Të shpjegojë mënyrat e transportit të sigurtë të fidanëve.

Rezultatet e të nxënësve në shprehje profesionale

1. Të përgatitë fidanishten për prodhimin e fidanëve;
2. Të mbjellë fara dhe copa në farishte/copëtore;
3. Të kryejë shartimin e filizave dhe copave vegjetative në fidanishte;
4. Të kryejë shërbimet agroteknike në fidanishte;
5. Të kryejë shkëlqesën, pastrimin, standardizimin, transportin dhe shtratifikimin e fidanëve;

Kriteret e vlerësimit

- Përzgjedh farat dhe copat për prodhimin e fidanëve nga pemët frutore, sipas standardeve;
- Përgatit farishten për mbjelljen e farës dhe copave sipas teknikave përkatëse;

- Përgatit shtratin e nxehtë për mbjelljen e farës sipas kriterëve të përcaktuara;
- Ruan raportet për përgatitjen e dherishtës sipas standardeve;
- Përpunon mbetjet organike në përgatitjen e dherishtës sipas standardeve;
- Përcakton mënyrat, afatin, distancat dhe thellësinë e mbjelljes së farave në farishte dhe copave në copëtoje, sipas teknologjisë së prodhimit të fidanëve;
- Përcakton mënyrat, afatin, distancat dhe thellësinë e mbjelljes së farave dhe copave në shtratin e nxehtë, sipas teknologjisë së prodhimit të fidanëve;
- Zbaton teknikat e shartimit të filzave dhe copave në shartesore sipas llojit të kulturës;
- Kryen shkulljen, pastrimin dhe standardizimin e fidanëve sipas standardeve;
- Kryen transportin sipas teknikave përkatëse;
- Kryen shtratifikimin e fidanëve sipas standardeve.

H1-08-III-0155-24 Teknologjitë e kultivimit në pemëtore dhe vreshta

Rezultatet e të nxënësve në njohuri

1. Të përshkruajë teknologjitë e kultivimit të kulturave drufrutore (farore e bërthamore);
2. Të përshkruajë teknologjitë e kultivimit të vreshtave;
3. Të përshkruajë teknologjitë e kultivimit të ullishteve;
4. Të përshkruajë teknologjitë e kultivimit të agrumeve;
5. Të përshkruajë kultivarët kryesorë të pemëve frutore farore, bërthamore, arvore, etj;
6. Të përshkruajë kultivarët kryesorë të hardhive;
7. Të përshkruajë kultivarët kryesorë të ullirit për vaj dhe për ngrënie;
8. Të përshkruajë kultivarët kryesorë të agrumeve;
9. Të përshkruajë mënyrat dhe mjetet që përdoren në sistemimin e tokës për ngritjen e pemëtoreve dhe vreshtave të reja;
10. Të shpjegojë mënyrat, llojet dhe teknikat e plehërimit bazë të tokës me plehra organike dhe minerale;
11. Të përshkruajë llojet dhe mënyrat e përdorimit të sensorëve digjital në përcaktimin e sasive të elementëve ushqyes dhe lagështirës në tokë;
12. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e grumbullimit dhe përpunimit (kompostimit) të mbetjeve organike;
13. Të përshkruajë hapat teknologjikë të punimeve para mbjelljes së fidanit;
14. Të shpjegojë mënyrat, llojet, teknikat dhe mjetet e punimit bazë të tokës;
15. Të shpjegojë mënyrat, teknikat dhe mjetet për dezinfektimin e tokës;
16. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e piktimit të tokës për mbjelljen e fidanëve sipas kushteve klimatiko-tokësore të zonës ku do ngrihet blloku i pemëtoreve dhe vreshtave;
17. Të argumentojë përzgjedhjen e kultivarëve të kulturave drufrutore, hardhive, ullirit dhe agrumeve sipas zonave klimatiko –tokësore;
18. Të përshkruajë proceset e punës të mbjelljes së pemëve të reja frutore dhe hardhive;
19. Të përshkruajë teknikat dhe mjetet për hapjen e gropave për mbjelljen e fidanëve;
20. Të përshkruajë metodat e përzgjedhjes së fidanëve për mbjellje;
21. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbjelljes së fidanëve;
22. Të rendisë sistemet e mbjelljes së pemëve frutore dhe vreshtave;
23. Të përshkruajë sistemet e ndryshme të mbështetjes dhe mënyrat e lidhjes që përdoren në pemëtore e vreshta;

Rezultatet e të nxënësve në shprehje profesionale

1. Të përzgjedhë kulturat drufrutore dhe hardhitë sipas teknologjive të kultivimit dhe kërkesave të tregut;
2. Të zbatojë hapat teknologjikë për ngritjen e pemëtoreve dhe vreshtave dhe mbjelljen e fidanëve;
3. Të zbatojë teknologjinë e kultivimit të kulturave drufrutore dhe hardhive;
4. Të zbatojë hapat teknologjikë për mbjelljen e fidanëve të kulturave drufrutore dhe hardhive;
5. Të përdorë sensorë digjital në përcaktimin e sasive të elementëve ushqyes dhe lagështirës në tokë;
6. Të zbatojë mënyrat dhe teknikat e grumbullimit dhe kompostimit të mbetjeve organike;
7. Të vendosë sistemet e ndryshme të mbështetjes dhe mënyrat e lidhjes që përdoren në pemëtore e vreshta;

Kriteret e vlerësimit

- Vlerëson rëndësinë ekonomike të kultivimit të kulturave drufrutore dhe hardhive sipas kërkesave të tregut;
- Përzgjedh llojet e kulturave drufrutore dhe hardhive sipas teknologjive të kultivimit dhe kërkesave të tregut;
- Përzgjedh kultivarët kryesorë të pemëve frutore farore, bërthamore dhe arrorë sipas teknologjive të kultivimit të tyre;
- Përzgjedh kultivarët kryesorë të hardhive sipas teknologjive të kultivimit të tyre;
- Përzgjedh kultivarët kryesorë të ullirit për vaj dhe për ngrënie sipas kërkesave të tregut;
- Përzgjedh kultivarët kryesorë të agrumeve sipas kërkesave të tregut;
- Zbaton procedurat për ngritjen e plantacioneve drufrutore dhe vreshtave sipas standardeve dhe teknologjive të prodhimit;
- Kryen sistemimin e tokës për ngritjen e pemëtoreve të reja dhe vreshtave sipas teknologjive;
- Kryen punimin bazë të tokës sipas llojit të kulturës drufrutore;
- Kryen plehërimin bazë të tokës me plehra organike dhe minerale sipas llojit të kulturës drufrutore;
- Kryen dezinfektimin e tokës, sipas teknikave përkatëse;
- Kryen piketimin e tokës për mbjelljen e fidanëve të kulturave drufrutore dhe hardhive sipas teknikave përkatëse;
- Kryen kompostimin e mbetjeve organike sipas teknikave përkatëse;
- Zbaton teknologjitë e kultivimit të kulturave drufrutore, sipas standardeve dhe llojit të kulturave;
- Zbaton teknologjitë e kultivimit të vreshtave sipas standardeve;
- Zbaton teknologjitë e kultivimit të ullishtave sipas standardeve;
- Zbaton teknologjitë e kultivimit të agrumeve sipas standardeve;
- Zbaton format e mbjelljes së pemëve frutore dhe vreshtave, sipas standardeve;
- Kryen hapjen e gropave për mbjelljen e fidanëve, sipas teknikave përkatëse;
- Përzgjedh fidanët për mbjellje, sipas standardeve;
- Kryen mbjelljen e fidanëve, sipas teknikave përkatëse;

- Realizon sistemet e mbështetjes dhe lidhjes së fidanëve në pemëtore dhe vreshta, sipas teknikave përkatëse;
- Përdor sensorët digjital në përcaktimin e sasive të elementëve ushqyes dhe lagështirës në tokë, sipas manualeve;

H1-08-III-0156-24 Shërbimet agroteknike dhe vjelja në pemëtore e vreshta

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë llojet e shërbimeve agroteknike dhe kalendarin e kryerjes së tyre në pemët frutore dhe vreshta;
2. Të shpjegojë teknikat e kontrollit të zënies dhe zëvendësimit të fidanëve;
3. Të shpjegojë teknikat e kryerjes së punimeve plotësuese të tokës;
4. Të listojë llojet e plehrave që përdoren në plehërimin plotësues dhe atë gjethor me plehra organike dhe minerale;
5. Të shpjegojë mënyrat, teknikat, sasitë dhe kohën e plehërimit plotësues dhe gjethor;
6. Të listojë pajisjet digjitale për monitorimin e sasisë së ushqyesve për plehërimin dhe ujitjen e kulturave drufrutore dhe hardhive;
7. Të shpjegojë teknikat dhe llojet e krasitjeve të pemëve frutore dhe vreshtave;
8. Të shpjegojë teknikat për krasitjen e gjelbër të pemëve frutore dhe hardhive;
9. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e prognozë-sinjalizimit të përhapjes së sëmundjeve dhe dëmtuesve në pemëtore dhe vreshta;
10. Të shpjegojë llojet, metodat dhe teknikat për kontrollin e sëmundjeve, dëmtuesve dhe barërave të egra;
11. Të përshkruajë metodat e kontrollit digjital të dëmtuesve të pemëve frutore dhe hardhive;
12. Të listojë llojet e produkteve të lejuara për kontrollin e sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve;
13. Të shpjegojë metodat dhe teknikat e përcaktimit të kohës së pjekjes për vjelje;
14. Të listojë platformat digjitale për monitorimin e kohës së vjeljes së prodhimeve frutore;
15. Të shpjegojë metodat dhe teknikat e vjeljeve të prodhimeve frutore;
16. Të shpjegojë mënyrat e grumbullimit dhe transportit të sigurt të prodhimeve frutore;
17. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e seleksionimit të prodhimit frutore;
18. Të argumentojë përcaktimin e kushteve të magazinimit të prodhimeve frutore;
19. Të listojë llojet dhe mënyrat e ambalazhimit të prodhimeve frutore;
20. Të shpjegojë kushtet dhe masat mbrojtëse për ruajtjen e prodhimeve frutore;

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të kryejë punime plotësuese në pemëtore dhe vreshta;
2. Të kryejë plehërime plotësuese në pemëtore dhe vreshta;
3. Të kryejë ujitje plotësuese në pemëtore dhe vreshta;
4. Të kryejë krasitje (dimërore/verore) në pemëtore dhe vreshta;
5. Të kryejë mbrojtjen e bimëve nga sëmundje, dëmtues dhe barërat e egra në pemëtore dhe vreshta;
6. Të realizojë vjeljen, magazinimin dhe ruajtjen e prodhimeve frutore;

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton mënyrat, teknikat, sasitë dhe koha e plehërimit plotësues dhe gjethor sipas llojit

- të kulturës drufrutore;
- Instaloni sistemin e ujitjes dhe kryen ujitjen e pemëve frutore dhe vreshtave sipas llojit të kulturës;
 - Kryen krasitje formuese dhe prodhuese në pemë frutore dhe vreshta, sipas teknikave përkatëse;
 - Kryen krasitje të gjelbër të pemëve frutore dhe hardhive, sipas teknikave përkatëse;
 - Zbaton teknikat e prognozë-sinjalizimit të përhapjes së sëmundjeve dhe dëmtuesve sipas llojit të pemëve frutore dhe vreshtave;
 - Përzgjedh llojet e produkteve të lejuara për kontrollin e sëmundjeve dhe dëmtuesve të pemëve frutore dhe vreshtave sipas listës së miratuar;
 - Zbaton metodat dhe teknikat për kontrollin e sëmundjeve, dëmtuesve dhe barërave të egra, sipas llojit të pemëve frutore dhe vreshtave;
 - Kryen kontrollin digjital të dëmtuesve të pemëve frutorë dhe hardhive, sipas teknikave përkatëse;
 - Përdor pajisjet digjitale për monitorimin e sasisë së ushqyesve për plehërimin dhe ujitjen e kulturave frutore dhe vreshtave sipas manualeve përkatëse;
 - Përdor metodat dhe teknikat e duhura të përcaktimit të kohës së pjekjes për vjelje, sipas destinacionit të përdorimit;
 - Zbaton metodat dhe teknikat e vjeljeve të prodhimeve frutore sipas llojit të kulturës;
 - Kryen grumbullimin dhe transportin e sigurtë të prodhimeve frutore sipas standardit;
 - Seleksionon prodhimet frutore, sipas mënyrave dhe teknikave përkatëse;
 - Magazinon prodhimet frutore sipas standardeve;
 - Ambalazhon prodhimet frutore, sipas kërkesave të tregut;
 - Ruan prodhimet frutore, sipas kushteve përkatëse;

H1-08-III-0157-24 Përpunime të thjeshta të prodhimeve të pemëve frutore

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë karakteristikat e përgjithshme të frutave që do të përpunohen;
2. Të klasifikojë frutat për lloje të ndryshme të përpunimit si: lëngje, komposto, reçel, marmelatë e fruta të thata etj.;
3. Të shpjegojë mënyrat, materialet dhe teknikat e pastrimit të produkteve frutore;
4. Të shpjegojë mënyrat e parapërgatitjes së lëndëve të para për përpunime të thjeshta;
5. Të përshkruajë mënyrën e prodhimit të lëngjeve, kompostos, reçelit, marmelatës dhe prevedesë në fruta të ndryshëm;
6. Të listojë llojet e konservantëve për përpunime të thjeshta të frutave dhe përdorimet e tyre;
7. Të përshkruajë teknikat për përpunimin e frutave për lëngje të shtrydhura;
8. Të përshkruajë mënyrën e prodhimit të frutave të thata;
9. Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së ullirit për ngrënie;
10. Të shpjegojë llojet, teknikat e ambalazhimit dhe rëndësia e përdorimit të ambalazheve ekologjike;
11. Të shpjegojë kushtet teknike për ruajtjen e produkteve të përpunuara;
12. Të përshkruajë kushtet e higjienës dhe sigurisë gjatë përpunimit të prodhimeve frutore.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përzgjedhë dhe parapërgatitë frutat për përpunime të thjeshta;
2. Të kryejë përpunime të thjeshta të frutave;
3. Të zbatojë kushtet e higjienës dhe sigurisë gjatë përpunimit të prodhimeve frutore.

Kritere vlerësimi

- Përzgjedh frutat për përpunim si: lëngje, komposto, reçel, marmelatë e fruta të thata, etj sipas kërkesave;
- Përzgjedh mënyrat, materialet dhe teknikat e pastrimit të produkteve frutore, sipas llojit;
- Parapërgatit lëndët e para për përpunime të thjeshta, sipas produktit;
- Prodhon lëngje, komposto, reçel, marmelatë dhe prevece në fruta të ndryshëm, sipas teknikave përkatëse;
- Përzgjedh llojet e konservantëve për përpunime të thjeshta të frutave sipas llojit të tyre;
- Prodhon lëngje të shtrydhura nga frutat, sipas teknikave përkatëse;
- Përgatit ullirin për ngrënie sipas teknikave përkatëse;
- Përzgjedh llojet e ambalazheve dhe ambalazhet ekologjike sipas standardeve;
- Zbaton teknikat e paketimit të produkteve frutore të përpunuara sipas standardeve;
- Zbaton kushtet teknike për ruajtjen e produkteve frutore të përpunuara, sipas standardeve;
- Zbaton kushtet e higjienës dhe sigurisë gjatë përpunimit të frutave, sipas standardeve;

H1-08-III-0158-24 Teknologjitë e prodhimit biologjik në frutikulturë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë ligjin shqiptar për bujqësinë biologjike;
2. Të përshkruajë direktivën evropiane për bujqësinë organike;
3. Të përshkruajë normat teknike për prodhimin biologjik në frutikulturë;
4. Të përshkruajë llojet e plehrave, metodat, teknikat dhe mjetet e plehërimit organik;
5. Të listojë plehrat organike dhe minerale/shtuesit e lejuar në bujqësinë biologjike në frutikulturë;
6. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e përpunimit të plehut organik;
7. Të shpjegojë mënyrat e punimeve të tokës, teknikat dhe mjetet e punimeve minimale;
8. Të përshkruajë metodat e ruajtjes së pjellorisë natyrore të tokës në bujqësinë biologjike;
9. Të listojë metodat dhe teknikat e analizimit të cilësive biologjike të tokës;
10. Të listojë metodat dhe teknikat e analizimit të cilësive fiziko-kimike e biologjike të ujit;
11. Të përshkruajë metodat dhe teknikat e prodhimit biologjik të fidanëve në frutikulturë;
12. Të përshkruajë normat teknike të shërbimeve agroteknike në bujqësinë biologjike;
13. Të listojë preparatet e lejuara për mbrojtjen e bimëve në bujqësinë biologjike në frutikulturë;
14. Të përshkruajë metodat dhe teknikat që përdoren për kontrollin biologjik të dëmtuesve në frutikulturë;
15. Të listojë platformat digjitale për kontrollin e dëmtuesve në frutikulturën biologjike;
16. Të shpjegojë teknikat dhe mjetet për vjeljen e produkteve frutore biologjike;
17. Të shpjegojë teknikat dhe metodat e manipulimit të produkteve frutore biologjike të pas vjeljes;

18. Të përshkruajë llojet e ambalazheve ekologjike dhe teknikat e ambalazhimit;
19. Të përshkruajë normat teknike të kontrollit, certifikimit dhe etiketimit të produkteve frutore biologjike;
20. Të shpjegojë çfarë përfaqësojnë logot e prodhimit frutor biologjik dhe rëndësinë e tyre;
21. Të përshkruajë teknologjinë e grumbullimit dhe ruajtjes së prodhimeve frutore biologjike;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë ligjin shqiptar, direktivën evropiane dhe normat teknike në prodhimin biologjik në fermat e frutikulturës;
2. Të zbatojë teknologjinë e prodhimit biologjik në frutikulturë;
3. Të kryejë shërbimet agroteknike në frutikulturën biologjike;
4. Të kryejë ruajtjen, ambalazhimin, etiketimin, kontrollin dhe certifikimin e prodhimit biologjik në frutikulturë;
5. Të zbatojë teknologjinë e vjeljes, grumbullimit dhe ruajtjes së prodhimeve frutore;

Kritere vlerësimi

- Zbaton ligjin shqiptar për bujqësinë biologjike;
- Zbaton direktivën evropiane për bujqësinë organike;
- Zbaton normat teknike për prodhimin biologjik frutor sipas legjislacionit;
- Përdor llojet e plehrave, metodat, teknikat dhe mjetet e plehërimit organik sipas rregulloreve përkatëse;
- Përdor plehrat organike dhe minerale/shtuesit e lejuar në frutikulturën biologjike sipas rregulloreve përkatëse;
- Zbaton mënyrat dhe teknikat e përpunimit të plehut organik sipas rregulloreve përkatëse;
- Kryen punime të tokës, kryesisht punime minimale, duke përdorur mjetet, sipas rregulloreve përkatëse;
- Zbaton metodat e ruajtjes të pjellorisë natyrore të tokës në frutikulturën biologjike sipas rregulloreve përkatëse;
- Zbaton metodat dhe teknikat e kontrollit të cilësive biologjike të tokës sipas rregulloreve përkatëse;
- Zbaton metodat dhe teknikat e kontrollit të cilësive fiziko-kimike e biologjike të ujit sipas rregulloreve përkatëse;
- Zbaton metodat dhe teknikat e prodhimit të fidanëve në frutikulturën biologjike sipas rregulloreve përkatëse;
- Zbaton normat teknike të shërbimeve agroteknike në frutikulturën biologjike sipas rregulloreve përkatëse;
- Përdor preparatet e lejuara për mbrojtjen e bimëve në frutikulturën biologjike sipas legjislacionit;
- Zbaton metodat dhe teknikat për kontrollin biologjik të dëmtuesve në frutikulturë sipas rregulloreve përkatëse;
- Përdor pajisjet digjitale për monitorimin e kohës së vjeljes të produkteve frutore biologjike sipas manualeve të përdorimit;
- Zbaton teknikat dhe mjetet për vjeljen e prodhimeve frutore biologjike sipas rregulloreve përkatëse;

- Zbaton teknologjinë e grumbullimit dhe ruajtjes së e prodhimeve frutore biologjike sipas rregulloreve përkatëse.

H1-32-III-0013-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë parimet bazë të kodit të punës dhe legjislacionin përkatës lidhur me aktivitetin që kryen;
2. Të shpjegojë format dhe mënyrat e përpilimit dhe arkivimit të dokumentacioneve;
3. Të shpjegojë mënyrat e llogaritjeve të materialeve të punës;
4. Të përshkruajë mënyrat e hartimit të grafikut të punës;
5. Të shpjegojë mënyrat e regjistrimit të të dhënave për faturat dhe ofertat;
6. Të argumentojë rëndësinë e informimit nga tregu për çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe produkteve;
7. Të shpjegojë elementët e llogaritjes së kostos për prodhimin në frutikulturë;
8. Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së një oferte për produktet që do të ofrojnë;
9. Të shpjegojë mënyrat e sigurimit të mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të nevojshme;
10. Të shpjegojë teknikat e marketingut për produktet e frutikulturës;
11. Të përshkruajë llojet e institucioneve financiare dhe shërbimet e tyre;
12. Të përshkruajë nocionin e të ardhurave dhe shpenzimeve në frutikulturë;
13. Të përshkruajë mënyrat e vetvlerësimit;
14. Të përshkruajë metodat e zhvillimit profesional dhe të karrierës;
15. Të argumentojë rëndësinë e teknologjisë bashkëkohore për proceset e punës në specialitetin e frutikulturës;
16. Të përshkruajë mënyrat e transmetimit në kohë tek bashkëpunëtorët të njohurive dhe aplikimin e teknikave të reja në punë;
17. Të argumentojë rëndësinë e pjesëmarrjes në panaire dhe ekspozita;
18. Të përshkruajë llojet e trajnimeve dhe kurseve teknike.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë detyra administrative dhe tregtare;
2. Të zbatojë teknikat e marketingut;
3. Të zhvillohet profesionalisht;

Kritere vlerësimi

- Zbaton legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin e fushës;
- Plotëson planin e punës sipas detyrës së dhënë;
- Kryen llogaritje të thjeshta ekonomike sipas rregullave;
- Zbaton grafikun e punës, sipas proceseve;
- Kryen sigurimin e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve sipas nevojës;
- Zbaton teknikat e marketingut për prodhimet e frutikulturës sipas kërkesave të tregut;
- Plotëson dokumentacionin për bashkëpunimet me institucionet financiare sipas nevojës;
- Përgatit oferta për produktet referuar çmimeve aktuale të tregut;
- Regjistron të dhënat e faturave të shitjes dhe marrjes së porosive sipas kërkesës;
- Llogarit koston dhe çmimin përfundimtar për prodhimet sipas rregullave;

- Merr informacion nga tregu për çmimet dhe cilësinë e inputeve bujqësore;
- Kryen vazhdimisht trajnime për zhvillimin profesional dhe të karrierës;
- Merr pjesë vazhdimisht në panairë dhe ekspozita në fushën e frutikulturës;
- Përdor teknologjinë bashkëkohore për proceset e punës në frutikulturë, sipas rregullave;
- Informon në kohë bashkëpunëtorët për zbatimin e teknikave të reja në frutikulturë;

H1-31-III-0014-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë mënyrat e dhënies/marrjes së informacionit për problemet dhe të rejat e ditës;
2. Të shpjegojë metodat e komunikimit;
3. Të argumentojë zbatimin e parimeve të punës në grup;
4. Të shpjegojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
5. Të shpjegojë kodin e etikës profesionale;
6. Të përshkruajë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik;
7. Të përshkruajë mënyrat e bashkëpunimit me eprorët dhe kolegët;
8. Të shpjegojë përdorimin e teknologjisë së informacionit në komunikimin me të tjerët;
9. Të argumentojë përdorimin e terminologjisë profesionale;
10. Të argumentojë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj..

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë teknikat e komunikimit;
2. Të zbatojë kodin e etikës;
3. Të zbatojë terminologjinë profesionale në fushën e frutikulturës;

Kritere vlerësimi

Merr informacion të vazhdueshëm mbi problemet dhe të rejat e ditës sipas teknikave përkatëse;

- Zbaton parimet e punës në grup sipas teknikave përkatëse;
- Zbaton rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët sipas kodit të etikës;
- Zbaton teknikat e komunikimit për të arritur një komunikim efektiv;
- Zbaton kodin e etikës në mënyrë korrekte;
- Zgjidh probleme dhe mosmarrëveshje duke përdorur teknikat përkatëse;
- Bashkëpunon me eprorët dhe kolegët sipas rregullores së brendshme;
- Përdor saktë terminologjinë profesionale të fushës së frutikulturës;
- Zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.

H1-08-III-0047-24 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe standardet për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e mjedisit;
2. Të shpjegojë domosdoshmërinë e përdorimit të manualeve të mjeteve dhe pajisjeve të

- punës;
3. Të listojë mënyrat dhe llojet e mjeteve të ndihmës së parë në rast aksidenti;
 4. Të interpretojë sinjalistikën në mjedisin e punës;
 5. Të shpjegojë procedurat e evakuimit për raste emergjence;
 6. Të përshkruajë përdorimin e pajisjeve, rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;
 7. Të shpjegojë masat përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
 8. Të argumentojë domosdoshmërinë e përdorimit të kufizuar të pesticideve në ruajtjen e mjedisit nga ndotjet kimike;
 9. Të përshkruajë karakteristikat e mjedisit të qëndrueshëm;
 10. Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
 11. Të përshkruajë rregulloret përkatëse për depozitimin e mbetjeve;
 12. Të përshkruajë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
 13. Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat e riciklimit të mbetjeve organike bimore;
 14. Të përshkruajë protokollet e duhura në raste të gjendjeve të jashtëzakonshme;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë legjislacionin dhe standardet e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjen e shëndetit;
2. Të zbatojë mënyrat e dhënies të ndihmës së parë në rast aksidenti;
3. Të zbatojë sinjalistikën në mjedisin e punës dhe procedurat e evakuimit për raste emergjence;
4. Të zbatojë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;
5. Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit;
6. Të zbatojë rregullat e sigurisë për ruajtjen e mjedisit nga ndotja dhe mbetjet e ndryshme;

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton legjislacionin në fuqi dhe standardet për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Përdor manualët e mjeteve dhe pajisjeve të punës sipas rastit;
- Zbaton rregullat e dhënies të ndihmës së parë në rast aksidenti sipas rastit;
- Zbaton sinjalistikën në mjedisin e punës sipas sektorëve;
- Zbaton procedurat e evakuimit për raste emergjence sipas llojit;
- Zbaton rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit sipas rregulloreve përkatëse;
- Zbaton masat gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike sipas rregulloreve përkatëse;
- Përdor në mënyrë të kufizuar pesticidet për ruajtjen e mjedisit nga ndotjet kimike sipas rregulloreve përkatëse;
- Respekton karakteristikat e mjedisit të qëndrueshëm sipas rregulloreve përkatëse;
- Zbaton rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve sipas llojit dhe rregulloreve përkatëse;
- Zbaton rregulloret për depozitimin e mbetjeve sipas udhëzimeve përkatëse;
- Zbaton rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit sipas rregulloreve përkatëse;
- Zbaton mënyrat dhe teknikat e riciklimit të mbetjeve organike bimore sipas rregulloreve

përkatëse;

- Zbaton protokollet e duhura në raste të gjendjeve të jashtëzakonshme;

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Planifikimi dhe organizimi i punës në frutikulturë	10	H1-08-III-0152-24
2	Kushtet mjedisore të fermës për prodhimin në frutikulturë	8	H1-08-III-0153-24
3	Teknologjia e prodhimit të fidanëve të pemëve frutore dhe hardhive	10	H1-08-III-0154-24
4	Teknologjitë e kultivimit në pemëtore dhe vreshta	25	H1-08-III-0155-24
5	Shërbimet agroteknike dhe vjelja në pemëtore dhe vreshta	12	H1-08-III-0156-24
6	Përpunime të thjeshta të prodhimeve frutore dhe rrushit	5	H1-08-III-0157-24
7	Teknologjitë e prodhimit biologjik në frutikulturë	9	H1-08-III-0158-24
8	Sipërmarrje dhe edukim karriere	8	H1-32-III-0013-24
9	Komunikimi dhe etika profesionale	6	H1-31-III-0014-24
10	Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit	7	H1-08-III-0047-24
Totali		100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kritereve të caktuara.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të specifikuar.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit.

Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm

sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- ç) njohjes të të nxënës të mëparshëm informal dhe joformal;
- d) njohjes të të nxënës të përfutur jashtë vendit;
- dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **K-H1-III-24**

K - Kualifikim

H - Shkronja që identifikon drejtimin e kualifikimit

1 - Numri që identifikon profilin e kualifikimit përkatës

III - Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK

24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënës: **H1-08-III-0152-24**

H1 - Shkronja që identifikon drejtimin dhe profilin e kualifikimit

08 - Numri që identifikon orientimin e Njësisë së të Nxënës

III - Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënës në strukturën e KSHK

0152 - Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësisë së të Nxënës në ditën e hartimit përkatës

24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënës